



Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/65 Nr. i faq./Br.str./No.pg -

Data/Datum/Date 30 / 04 / 2020

Në bazë të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17, nenit 24 dhe nenit 40 paragrafi 2 shkronja c) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), dispozitave të Ligjit Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, dispozitave Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjit Nr. 05/L -108 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 30.04.2020 miraton këtë:

VENDIM

Për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2018 dhe 2019 në vitin 2020

1. **Miratohet** vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara në vitin 2018 dhe 2019 në vitin 2020 në shumën prej **232,776.90 € (dyqind e tridhjetë e dy mijë shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë euro e nëntëdhjetë cent)**.
2. Mjetet në shumën prej **232,776.90 € (dyqind e tridhjetë e dy mijë shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë euro e nëntëdhjetë cent)** do të barten në vitin 2020 për alokim dhe shpenzim në këto programe dhe kategori buxhetore si në vijim:

Investimet kapitale në shumë prej:	210,000.90 €
Mallra dhe Shërbime në shumën prej:	850.00 €
Paga dhe Mëditje në shumë prej:	21,926.00 €
TOTALI	232,776.90 €

3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-në dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb-faqen e Komunës së Rahovecit.

Vendimi u dërgohet:

- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

01 Nr. 65 /2020
Datë: 30.04.2020

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT

